



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Datë: 24.02.2024
Numër Protokolli: 1314/2025

A.nr.61/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari, kryetare, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj-Demi, anëtar, me Atdhe Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.61/2025, të datës, 10.01.2025, të parashtruar nga ankuesi F.A., kundër organit të punësimit/ Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, në çështjen juridike “*Kompensim material*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosies së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 24.02.2024, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e pasafatshme ankesa me numër A.nr.61/2025, e datës 10.01.2025, e parashtruar nga ankuesi, F.A.

A r s y e t i m

Nëpunësi civil F.A. (*tutje referuar vetëm* Ankuesi), i punësuar në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, më datë 10.01.2025 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 7001/2024 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me Nr.Ref.02/279 të datës 22.11.2024, të U.D Sekretares së Përgjithshme në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, me të cilin akt ankuesit i është refuzuar kërkesa për lidhur me kompensimin për funksione shtesë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*me tej Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosies së Ankesave, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, ndërsa, kjo e fundit, me datë 30.01.2025, ka përcjell përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat referuar çështjes në procedurë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosien e Ankesave pasi ka shqyrtuar provat materiale të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi së ankesa e ankuesit, **është e pasafatshme, sepse:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës, Kolegji i Këshillit, ka gjetur se ankuesi sipas Akt emërimit të datës 05.01.2015, është i punësuar në pozitën e punës *Zyrtar për rindërtim*, në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

Tutje, Komisioni Ndërmintor për Investime Strategjike, përmes Vendimit me Nr.Ref.01/92 të datës 12.12.2023, ka formuar grupin operacional për shqyrtimin dhe vlerësimin e dokumentacionit të aplikuesit-subjektit investues “INVIOS GROUP LLC”, dhe si për rrjedhojë ankuesi është caktuar anëtar i këtij grupi.

Si rrjedhojë, Grupi operacional për shqyrtimin dhe vlerësimin e dokumentacionit të aplikuesit-subjektit investues “INVIOS GROUP LLC”, përmes Kryesueses kanë parashtruar kërkesë me datë 31.10.2024, tek Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, lidhur me pretendimin për kompensimin material për funksion shtesë mbi bazën ligjore sipas Rregullores (QRK) Nr.10/2023 Nr.10/2023 për Kompensimin e Funksioneve Shtesë.

Ndërsa, U.D Sekretarja e Përgjithshme në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, përmes Vendimit Ref.02/279 të datës 22.11.2024, ka refuzuar kërkesën e Grupit operacional për shqyrtimin dhe vlerësimin e dokumentacionit të aplikuesit-subjektit investues “INVIOS GROUP LLC”, mbi arsyetimin se anëtarët e grupit përkatës nuk plotësojnë kriteret e përcaktuara sipas akteve ligjore dhe nën ligjore, lidhur me kompensimin për funksione shtesë.

Ankuesi, në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon kompensimin në emër të funksionit shtesë për shkak të angazhimit në cilësinë e anëtarit së grupit përkatës.

Kolegji i Këshillit lidhur me pranueshmerinë e ankesës iu referua dispozitave të ligjit Nr.08/L-197 për Zyrarët Publikë, përkatësisht nenit 27 paragrafi 3, ku përcaktohet se: *3. Nëpunësja/i civil ka të drejtë të paraqes ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto që burojnë nga marrëdhënia e punës në shërbimin civil;* si dhe dispozitave të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht nenit 124 paragrafi 1, ku përcaktohet se: *1. Pala ka të drejtë të ushtrojë mjetet juridike administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi administrativ, nëse pretendon se të drejtat apo interesat e saj juridike cenohen nga ky veprim apo mosveprim...;* ndërlidhur me nenin 127 paragrafi 1 i këtij ligji, ku është përcaktuar se: *1. Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ;* dhe si rrjedhojë duke bazuar në kuadrin përkatës ligjor si dhe nga shqyrtimi dhe analizimi i provave të lëndës Kolegji konstatoi se ankesa e parashtruar nga ankuesi, është e pasafatshme, ngase ankuesi sikurse edhe të gjithë anëtarët tjerë të grupit përkatës, përmes shkresës elektronike zyrtare të datës 09.12.2024, të Kryesueses së grupit operacional për shqyrtimin dhe vlerësimin e dokumentacionit të aplikuesit-subjektit investues “INVIOS GROUP LLC, janë njoftuar lidhur me Vendimin me Ref.02/279 të datës 22.11.2024, ndërsa ankuesi kundër këtij akti ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 10.01.2025, nga rrjedh se ankesa është parashtruar jashtë afatit të përcaktuar me dispozitat e nenit 127 paragrafit 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe si e tillë është e pa pranueshme në kuptim të nenit 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Kështu që për sa me sipër dhe duke u bazuar nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi që të hedhë poshtë ankesën si të pasafatshme, si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.61/2025

Atdhe GASHI

Procesmbajtës

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit F.A.;
- Udhëheqëses së Njesisë së Burimeve Njerëzore në MINT dhe MMPHI; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.